



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

---

**PROCESVERBAL**  
**Nga mbledhja e X-të për vitin 2011, e Kuvendit Komunal në**  
**Vushtri, mbajtur më 27.10.2011**

---

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën **10:13**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri: Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Esat Beka, Ferit Idrizi, Gani Imeri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Selim Rustemi, Nysret Gërxhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Syla, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Vlora Qirezi, Xhemajl Pllana, Xhylsime Feka dhe Zeqir Hasani.

Mungoi: Avdullah Halimi.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO-së (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë.

**Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit-** paraqiti rendin e ditës ashtu siç është në ftesë, por për “të ndryshme” propozoi që të futen edhe tri propozim-vendime, e që janë:

- a. Propozim-vendimi për transferimin e mjeteve nga mbetjet e projektit kapital të tenderuar të DSHMS-së;
- b. Propozim-vendimi për transferimin e mjeteve buxhetore të komunës;
- c. Propozim-vendimi për transferimin e mjeteve të lira.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit-** Grupi parlamentar i PDK-së e përkrah rendin e ditës, dhe përkrah edhe tri propozim-vendimet në “të ndryshme”.

**Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit-** Grupi parlamentar i LDK-së e përkrah rendin e ditës, dhe paraqiti reagimin e grupit në fjalë për faktin që në çdo seancë po vijnë pika shtesë të rendit të ditës, dhe shtoi se prej seancës së ardhshme nuk do të marrin pjesë në shqyrtimin e pikave shtesë të rendit të ditës, përveç atyre që janë urgjente.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** duke iu referuar pikave shtesë të rendit të ditës, tha se gjithmonë ka pasur dhe do të ketë pika shtesë të rendit të ditës. Pastaj

sqaroi se është fjala për mjete të lira, duke shtuar se në rastin konkret me një vendim të këtij kuvendi, kryetari i komunës është autorizuar që t'i ridestinoj mjetet e lira aty ku ka nevojë, por zyrtar nga ministria kanë kërkuar që të ketë vendim të kuvendit, prandaj është rast urgjent që duhet proceduar dhe aprovuar në kuvend.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** paraqiti vërejtje lidhur me marrjen e përgjigjes në ditën e mbajtjes së seancës, kurse pyetjen e ka bërë në seancën e kaluar, para një muaji, dhe shtoi se kjo ia pamundëson leximin e përgjigjes tani. Gjithashtu paraqiti vërejtje për mungesën e nëshkrimit të kryesuesit dhe vula në rekomandimet që janë dërguar nga mbledhja e fundit e KPF-së.

**Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit-** Grupi parlamentar i AAK-së e përkrah rendin e ditës, por pyeti pse nuk janë futur në rend dite pikat e rendit të ditës, që janë: Informata për të hyrat dhe shqyrtimi i parë i plotësimit dhe ndryshimit të Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke kërkuar që në të ardhmen të futen në rend dite.

**Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar Rregullores së punës që është në fuqi, në nenin 19 thuhet: "përgjigjet në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit të parashtruara nga mbledhja paraprake", pastaj të procedohet me rendin e ditës. Në vazhdim tha se ka marrë një përgjigje për pyetjen e tij nga mbledhja e kaluar, por nuk është fare i kënaqur me atë përgjigje, duke shtuar se problematikën që e ka ngritur për përdorimin e madh të drogës në Komunën e Vushtrrisë e ka dëgjuar nga mediat e ndryshme.

**Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi në mënyrë unanime miratoi këtë:**

## **R E N D I T E**

- 1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.**
- 2. Shqyrtimi i raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe për realizimin e planeve investuese për periudhën Janar-Shtator 2011.**
- 3. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2010/2011 dhe përgatitjet për vitin shkollor 2011/2012.**
- 4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për mbrojtjen e mjedisit (shqyrtimi i parë).**
- 5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës-tokës bujqësore dhe kullotat.**
- 6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.**
- 7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e ditës festive "Dita e Patates".**
- 8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për lejimin e mjeteve për transportimin e nxënësve të këtyre fshatrave: Kollë, Gumnishtë, Karaçë, Mihaliq dhe Liqej.**
- 9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për sigurimin e mjeteve për transportimin e nxënësve për këto shkolla: "Liria", "Azem Bejta" dhe "Andon Zako Çajupi".**
- 10. Shqyrtimi i Planit të Veprimtë për përmirësimin e shërbimeve publike.**
- 11. Të ndryshme:**
  - a. Propozim-vendimi për transferimin e mjeteve nga mbetjet e projektit kapital të tenderuar të DSHMS-së;**
  - b. Propozim-vendimi për transferimin e mjeteve buxhetore të komunës;**
  - c. Propozim-vendimi për transferimin e mjeteve të lira;**
  - ç. Pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.**

## **1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.**

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar nenit 50.1 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, në procesverbal duhet të shënohen emrat e anëtarëve të pranishëm të kuvendit të komunës, prandaj kërkoj që të respektohet neni në fjalë dhe të shënohen emrat e anëtarëve të kuvendit të pranishëm në seancat e KK-së.

**Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit-** tha se në faqen 6 në diskutimin e tij lidhur me rregullimin e një rruge duhet përmendur në procesverbal lagjet “Ferizi, Islami, Peci dhe Hajdari” në fshatin Bruznik.

***Aprovohet në mënyrë unanime procesverbali i mbledhjes së Kuvendit të Komunës, me vërejtjet nga B.Jashari dhe I.Gashi.***

## **2. Shqyrtimi i raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe për realizimin e planeve investuese për periudhën Janar-Shtator 2011.**

**Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar raportit në fjalë, tha se raporti është i dëmtuar edhe nga pjesa e formës dhe përmbajtjes, veçanërisht nga ajo e cilësisë, dhe i tërë raporti është i mbështetur në buxhetin dhe investimet kapitale, dhe fatkeqësisht kështu ishte edhe vitin e kaluar, por edhe përkundër paraqitjes së vërejtjeve nga ana e tij, nuk është përmirësuar asgjë. Pastaj tha se raportit në fjalë i mungojnë të dhënat më elementare për t’u shqyrtuar si: raporti nuk tregon asnjë indikator të matjes së performancës së administratës komunale karshi ekonomisë së Vushtrrisë si komunitet; raporti përveç të dhënave të buxhetit, me të cilat ka operuar administrata komunale, formave të prokurimeve dhe bizneseve të regjistruara, nuk ofron asnjë të dhënë tjetër dhe as analizën më të thjeshtë; raporti nuk ofron as pasqyrën vlerësuese të aseteve në Komunën e Vushtrrisë; raporti nuk ofron të dhëna për të hyrat e bizneseve, institucioneve dhe ekonomive familjare në Komunën e Vushtrrisë; raporti nuk ofron të dhëna për detyrimet afatshkurta dhe afatgjata të bizneseve, të institucioneve që operojnë në Komunën e Vushtrrisë dhe të ekonomive familjare; cila është norma e kthimit të investimeve në Komunën e Vushtrrisë, të paktën tek bizneset; raporti nuk ofron asnjë shifër për kapitalin, të paktën për institucionet dhe bizneset në Komunën e Vushtrrisë, ashtu sikurse as për ekuitetin, fitimet e mbajtura për këtë periudhë raportuese; raporti nuk ofron asnjë të dhënë për pozitën financiare të subjekteve të sipërcekura dhe as për rrjedhën dhe gjendjen e parave të gatshme; raporti nuk ofron të dhëna për nivelin e pagesës së TVSH-së në kufi për importet e bizneseve dhe institucioneve që operojnë në Komunën e Vushtrrisë, si dhe deshifrim i këtyre pagesave për investimet kapitale; sa është niveli i pagesave të tatimeve të mbajtura në burim, tatimeve në fitim dhe TVSH-së në shitje, dhe kjo paraqet një tregues se sa Komuna e Vushtrrisë i kontribuon taksambledhjeve të shtetit tonë; sa është vlera sasiore dhe financiare e eksporteve të bizneseve që operojnë në Komunën e Vushtrrisë; cila është rrethina ekonomike në Komunën e Vushtrrisë, dhe shtoi se raporti asnjë fjalë të vetme për çështjen kryesore nuk e përmban; qasja e ekonomisë vushtriase në burimet e financimit të bizneseve dhe ekonomive familjare; sa kohë mesatarisht mori transformimi i biznesit të vogël në biznesin e mesëm në Vushtrri; cilat pengesa u manifestuan në avancimin e pozitës ekonomiko-financiare të Komunës së Vushtrrisë, sa janë eliminuar gjatë periudhës referuese dhe sa të tilla mbesin për t’u bërë; cilët janë treguesit e matshëm të ngritjes së performancës të komunës në përmirësimin e ambientit ndërmarrës; cilët janë treguesit e matshëm se në periudhën referuese është ngritur cilësia e shërbimeve komunale ndaj bizneseve ekzistuese dhe kontributi i dhënë për hapjen e bizneseve të reja; raporti nuk ofron asnjë tregues të matshëm të qëndrueshmërisë së zhvillimit ekonomik dhe qëndrueshmërisë financiare të Komunës së Vushtrrisë.

**Zeqir Hasani, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar raportit në fjalë, tha edhe pse buxheti qendror i Republikës së Kosovës është aprovuar me vonesë, shpenzimi i mjeteve të buxhetit komunal ka qenë i kënaqshëm në formë kuantitative, kurse për të vlerësuar formën cilësore, duhet shikuar dhe vlerësuar projektet më vonë. Pastaj tha se të gjitha fondet janë shpenzuar në mënyrë të kënaqshme, përveç fondit 21 (të hyrat vetanake), ku ka një shpenzim më të ulët. Kurse lidhur me raportin e të hyrave vetanake për këtë periudhë, tha se ka një rritje të të hyrave vetanake, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dhe me planifikimin për këtë vit, por ka ende hapësirë për rritjen e këtyre të hyrave. Kurse kur flitet në raport për situatën ekonomiko-financiare, atëherë duhet shqyrtuar edhe disa pika lidhur me zhvillimin e ekonomisë, të bizneseve, punësimit, kushteve të jetesës së qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, numrit të të punësuarëve, shkallën e varfërisë etj.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit-** tha se Grupi parlamentar i PDK-së e përgëzon kryetarin e komunës dhe qeverinë komunale për angazhimet gjatë këtij nëntëmujori, duke shtuar se është bërë një punë e mirë, dhe më shumë se 80 % e buxhetit është shpenzuar. Në fund i përkrahu vërejtjet e paraqitura nga Z.Hasani.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar raportit të prezantuar në mbledhjen e KK-së më 29.09.2011, në atë raport një pjesë i kushtohet edhe sektorit të ekonomisë, dhe përmendet bujqësia, shërbimet publike, kurse në raportin e nëntëmujorit mungojnë ato pjesë, prandaj pyeti pse janë hequr? Pastaj tha se në këtë raport kryetari i komunës më shumë është përqendruar në pjesën financiare, kurse për pjesën e ekonomisë nuk ka pas çfarë të thotë, dhe e ka hequr të tërën. Mandej tha se situata ekonomike në Komunën e Vushtrrisë është jashtëzakonisht e keqe, në raport nuk ka asgjë që flet për investimet, kurse pa investime nuk ka punësim, duke shtuar se dihet gjendja e papunësisë në Komunën e Vushtrrisë, dhe përmendi rastin e një qytetareje të diplomuar dhe me nivelin master, e cila ka konkurruar 108 herë për t'u punësuar, por nuk është punësuar. Në vazhdim tha se raporti nuk merret fare me sektorin privat, kurse sektori privat është bartës i zhvillimit ekonomik dhe janë krijuar të vendeve të reja të punës, dhe përmendi disa investime të bëra nga disa biznese të Komunës së Vushtrrisë, prandaj kryetari i komunës së bashku me kabinetin e tij do të duhej të na raportonte në kuvend se nga po shkon ekonomia e komunës sonë, cila është gjendja e punësimit, sa të rinj presin që të marrin dokumente për ta lëshuar vendin në kërkim të punësimit. Gjithashtu duke iu referuar një shkrimi në gazetë, tha se djegia e 50 hektarëve të pyjeve është dëm i madh për ekonominë e Vushtrrisë, kurse në raport nuk thuhet asgjë.

**Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar raportit në fjalë, tha se është brengosëse çështja e punësimit të të rinjëve, çështja e varfërisë së skajshme, problemet sociale. Kurse lidhur me transportimin e nxënësve, pyeti se a kontrollohen se kush dhe si realizohet transportimi i nxënësve, duke shtuar se mungon një kontroll i duhur dhe nuk janë mjete të veçanta që duhej figuruar se janë për nxënës. Gjithashtu lidhur me transportimin e nxënësve, tha se në Gumnishtë nuk ka fare nxënës për klasët V-VIII, kurse në raport figuron që është bërë transportimi i nxënësve të fshatit në fjalë.

**Xhemajl Pllana, anëtar i Kuvendit-** tha se në raportin në fjalë është një tabelë tejet e varfër dhe jobindëse lidhur me planifikimin dhe realizimin e mbjelljeve pranverore, duke shtuar se nuk është e qartë se si është bërë planifikimi dhe realizimi i këtyre mbjelljeve, pasi që në këtë listë nuk ka të dhëna të përgjithshme. Pastaj në raport nuk thuhet as një fjali e vetme për dhjetëra hektarë të tokave më pjellore që komuna jonë po i humb pakthyeshëm për çdo vit, gjithashtu po humbin dhe degradohen edhe toka në nënsistemin e ujitjes (komasacionit), toka që japin dy deri tri të korrura gjatë vitit, toka që japin deri në 60 tonelata patate për hektar, toka që janë kapital tepër i çmuar dhe potencial i yni i ushqimit, zhvillimit dhe punësimit. Mandej tha se janë tepër shqetësuese arsyetimet e kryetarit të komunës dhe atyre të qeverisë se kështu po veprohet nëpër tërë Kosovën, pasi që fatkeqësisht me mijëra

hektarë të tokës po i shkatërrohen për çdo vit Republikës së Kosovës, dhe nuk ekziston as shqetësimi më i vogël nga pushtetarët tejet të papërgjegjshëm, dhe për më keq e tëra po bëhet nën bekimin e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave tona kapitale siç janë Ministria e Bujqësisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Mandej tha se asnjë objekt që është ndërtuar mbi tokat bujqësore nuk ka ndonjë arsyeshmëri ekonomike që do t'ia vlente për tjetërsimin e tyre, prandaj kryetari i komunës për këtë fushë nuk mund të mburret, pasi që nuk ka bërë asgjë për parandalimin e kësaj dukurie tejet të dëmshme për të sotmen dhe të ardhmen e qytetarëve tanë, sepse edhe për këtë çështje keni pasur mbështetjen edhe të opozitës, mbase vetëm të opozitës. Kurse sa i përket shërbimeve komunale, sidomos furnizimit me ujë të pijshëm, tha se kryetari i komunës dhe zyrtarët e komunës nuk kanë bërë asgjë sidomos në parandalimin e kyçjeve ilegale dhe keqpërdorimin e ujit të pijshëm. Poashtu nuk mund të lavdëroheni lidhur me mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, sepse ambienti është i papastër dhe përplot me mbeturina rreth e rrotull komunës sonë, kurse edhe ato hapësira gjelbëruese që kanë qenë, janë tjetërsuar pa arsyeshmëri, kurse komuna jonë nuk ka ku ta ndërtojë objektin komunal, prandaj është detyruar që objektin komunal ta ndërtojë në ish-tregun e gjelbërt, duke shtuar se ka qenë shqetësuese kërkesa e tij që të mos bëhet ndërrimi i parcelës së varrezave, sepse kemi mungesë të hapësirave për ndërtime të objekteve të nevojshme. Në vazhdim tha se pyjet tona po prehen pa kurrfarë kriteri, po bëhen djegie të dyshimta dhe po degradohet ambienti ynë, dhe e njëjta po veprohet edhe ndaj lumenjve tanë, të cilët po shfrytëzohen dhe po ndoten pamëshirshëm. Gjithashtu tha se kryetari i komunës nuk është duke i përmbushur premtimet e tij edhe sa i përket pajisjes me zërim të sallës së kuvendit, duke krijuar pështjellim dhe duke maltretuar anëtarët e kuvendit rreth daljes në foltore. Në fund tha se drejtshkrimi është katastrofal, pasi që propozim-vendimi rreth orarit të punës së bizneseve ka 40 gabime drejtshkrimore.

**Khylsime Feka, anëtare e Kuvendit-** tha se raporti në fjalë është një pasqyrë reale e të hyrave dhe gjendjes financiare në komunë, ku shihet se është bërë planifikim dhe shpenzim i mjeteve në suaza të arsyeshme. Pastaj shtoi se raporti është brenda konditave ligjore, dhe shihet qartë se qeveria komunale ka bërë dhe bën çmos për shfrytëzimin sa më racional të mjeteve financiare, prandaj Grupi parlamentar i PDK-së e përkrah plotësisht raportin në fjalë dhe punën e qeverisë komunale.

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa-** lidhur me vërejtjet e dhëna nga anëtarët e kuvendit, kanë më tepër karakter të një analize, se sa të raportit, pasi që raporti është bërë në vija të trasha për këtë periudhë, kurse në fund të vitit bëhen pasqyrat financiare në të cilat do të pasqyrohen të gjitha sugjerimet e paraqitura nga anëtarët e kuvendit.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** duke u bazuar në LVL, kryetari i komunës obligohet që të paraqes para kuvendit raportin e punës, në të cilin duhet treguar se qysh janë shpenzuar të hollat në bazë të planifikimit dhe në çfarë niveli janë duke u realizuar projektet, si janë realizuar të hyrat dhe si janë realizuar projektet, dhe në këtë mënyrë është përgatitur raporti në fjalë. Pastaj tha se është i kënaqur deri diku me të hyrat vetanake, duke shtuar se për këtë nëntëmujor është arritur të realizohen të hyrat e planifikuara. Gjithashtu, është pozitive që mjetet e planifikuara për 9 muaj, pjesa absolute është shpenzuar siç duhet, duke shtuar se edhe projektet që kuvendi i komunës i ka aprovuar për t'u realizuar, dhe që e ka autorizuar kryetarin e komunës për të realizuar projektet e caktuara, në përqindjen e plotë janë realizuar apo janë në realizim e sipër. Në vazhdim duke iu referuar raportit në fjalë, tha se nuk bëhet fjalë për raport pune, por është raport i situatës ekonomiko-financiare dhe për realizimin e planeve investuese. Kurse duke iu referuar akuzave që gjatë mandatit të tij janë zënë tokat bujqësore, tha se nuk pajtohet me konstatimin e tillë, duke shtuar se për herë të parë gjatë mandatit të tij ka filluar që të parandalohet zënia e tokës së bukës, dhe janë bërë rrënime të shtëpive dhe mureve të ndërtuara në pronën publike.

Pastaj lidhur me çështjen në fjalë pyeti se çfarë kanë bërë paraardhësit e tij në këtë pozitë për të ndaluar një dukuri të tillë. Gjithashtu, tha se nuk qëndron akuza se Komuna e Vushtrrisë më së shumti ka bërë zënie të tokës bujqësore, pasi që vetëm Komuna e Vushtrrisë i ka paraqitur të dhënat e sakta, kurse komunat tjera nuk e kanë bërë të njëjtën gjë.

**Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit-** tha se ka bërë përpjekje që t'i kontribuojë komunës dhe kryetarit që raporti me qenë i plotë, duke shtuar se nuk ka thënë që komuna nuk ka rezultate, se nuk është bërë shfrytëzimi i parasë publike mirë, por në këtë raport kryetari i komunës po sillet vetëm si kryetar i buxhetit komunal, kurse kryetari i komunës është kryetar i krejt bizneseve dhe ekonomive familjare që operojnë në Komunën e Vushtrrisë.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar zënies së tokave bujqësore, tha se Ministri i Bujqësisë dhe kryetari i komisionit për bujqësi i ka bërë këto vlerësime, pra vlerësimet e tilla kanë ardhur nga institucionet relevante. Gjithashtu, tha se ka pas edhe shkrime në gazeta ku thuhet se Komuna e Vushtrrisë prinë për nga zënia e sipërfaqeve bujqësore me tokë pjellore nënsistemin e ujitjes, prandaj duhet të sillemi konform saj. Pastaj në raport te ndërimi i tokës bujqësore në ndërtimore, thuhet se kanë qenë të planifikuara 4.500 € të hyra, që do të nxirren nga ndërimi i tokës bujqësore në ndërtimore, por kemi të hyra 30.000 €, dhe me këtë komuna nuk mund të mburret, pasi që kjo tregon se është zënë toka bujqësore.

**Xhemajl Pllana, anëtar i Kuvendit-** replikoi duke thënë që nuk e akuzoi kryetarin e komunës, por shtoi se edhe kryetari i komunës është dëshmitar që këtë shqetësim e kam pasur në të gjitha mandatet, dhe shqetësimin e njëjtë ia ka përcjellur edhe kryeministrit aktual të Kosovës. Në fund tha se është dashamirës i kryetarit të komunës dhe i çështjes së zhvillimit të Kosovës.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** tha se edhe tash ka zënie të tokës bujqësore, por ka më pak se më parë, por duhet parandaluar në tërësi, mirëpo duhet hartuar një plan, dhe përmendi projektin e parkut të biznesit, për të cilin janë paraqitur shumë të interesuar, por pritet pëlqimi nga ministrinë kompetente të Qeverisë së Kosovës për të ndërtuar parkun e biznesit.

### **3.Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2010/2011 dhe përgatitjet për vitin shkollor 2011/2012.**

**Vlora Qirezi, anëtare e Kuvendit-** tha se informata në fjalë është e vonuar, pasi që është paraqitur dy muaj pas fillimit të vitit shkollor. Pastaj lidhur me suksesin e përgjithshëm të shkollave fillore, të mesme dhe të larta, tha se edhe kësaj radhe Drejtorja e Arsimit nuk ka dhënë vlerësim se ky sukses është negativ apo pozitiv. Mandej tha se Grupi parlamentar i LDK-së kërkon që në seancën e ardhshme të ipet numri i saktë i nxënësve që janë regjistruar në klasën e X-të. Në vazhdim duke iu referuar “aktiviteteve të tjera të DA-së shkollave”, tha se është pozitive hapja e shkollës së muzikës në qytetin e Vushtrrisë, por hapja e shkollës së muzikës nuk bën pjesë në aktivitete, ashtu siç është paraqitur në informatën në fjalë, por është një ngjarje e madhe për qytetin tonë. Ndërsa tek vështirësitë me të cilat ballafaqohet arsimit në komunën tonë, është dashtë të theksohet se vështirësi është edhe mungesa e teksteve adekuate, posaçërisht në shkollat profesionale, ku mësimdhënësit diktojnë, dhe kjo nuk është metodë e përshtatshme e zhvillimit të njohurive të nxënësve. Gjithashtu vështirësi është edhe organizimi i kurseve private nga ana e mësimdhënësve, prandaj drejtorët e shkollave duhet të ndërmarrin masa ndaj mësimdhënësve që i detyrojnë nxënësit e vet të ndjekin kurse, pasi që kjo është blerje e notave. Ndërsa sa i përket mësimdhënësve me sëmundje kronike, Drejtorja e Arsimit së bashku me strukturat e shkollave duhet të gjejnë zgjidhje. Në vazhdim tha se duke pas parasysh gjendjen sociale-ekonomike të popullatës në komunën tonë, e që po ndikon edhe tek nxënësit, është e domosdoshme që në shkollat e

mesme të inkuadrohen psikologë. Në fund kërkoi nga Drejtoria e Arsimit që të hulumtojë zgjidhje që nxënësit e shkollave të mesme të larta gjatë pushimeve të gjata të mos dalin nga oborret e shkollave.

**Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit-** tha se informata në fjalë nuk është gjithëpërfshirëse. Pastaj tha se nga informata duhet të hiqen emërtimi “Sektori i Arsimit”, por duhet me qenë “Drejtoria e Arsimit”. Pastaj tha se kur janë përmendur institucionet shkollore, nuk është përmendur askund shkolla e muzikës, prandaj pyeti se a ka shkollë të muzikës, dhe sa është numri i nxënësve. Gjithashtu, në informatë mungon e dhëna për furnizim të shkollave me material pedagogjik. Mandej tha se duhet të informohemi se a janë bërë përgatitjet për mbajtjen e procesit mësimor gjatë stinës së dimrit. Në këtë informatë, kur flitet për maturën kombëtare, tha se ka fryrje të rezultatit, dhe ka tabela që nuk përputhen me njëra tjetrën, duke shtuar se nuk është e nevojshme të fryhen rezultatet, prandaj tabelat e paraqitura nuk janë të sakta. Kurse lidhur me vështirësitë, tha se një ndër vështirësitë në shkollat profesionale është mungesa e punëtorive, mungesa e teksteve për lëndët profesionale. Gjithashtu planprogramet vjetore janë të stërngarkuara, prandaj duhet shqyrtuar planprogramin në fjalë. Pastaj tha se puna praktike çalon, dhe nuk realizohet e plotë, prandaj në këtë drejtim duhet bërë hapat e parë. Në vazhdim, për regjistrimin e nxënësve, qoftë në klasën e I-rë, apo regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme, tha se nuk jemi të informuar nga Drejtoria e Arsimit, edhe pse ka kërkuar nga drejtoria në fjalë cilin drejtim, numrin e nxënësve, numrin e paraleleve, numri i arsimtarëve, duke shtuar se te shkollat e mesme ka klasë me 47 nxënës, kurse ka afër 30 shkolla që nuk kanë nxënës të mjaftueshëm të klasës së I-rë sipas kriterëve të Ministrisë së Arsimit. Në fund tha se shkollat profesionale duhet të favorizohen, kurse tek ne i ipet prioritet gjimnazeve, ndërsa në shkollat profesionale po i grumbullojmë nxënësit e dobët.

**Syzana Sylja, anëtare e Kuvendit-** tha se e përkrah fillimin me kohë të vitit shkollor me të gjitha përgatitjet për fillimin e procesit mësimor, dhe qysh në ditën e parë nxënësit e shkollave fillore janë pajisur me tekste shkollore, lokalet kanë qenë pjesërisht të përgatitura, pasi që disa shkollave iu mungon uji i pijshëm dhe kanë nevojë për riparimin e tualeteve. Kurse tha se ka vërejtje nga prindërit e nxënësve se oborret e shkollave fillore dhe të mesme nuk kanë ambient të pastër, prandaj kërkoi nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe nga Drejtoria për Arsim që të parashohin rregullimin e gjelbërimit në oborret e shkollave, duke i vendosur edhe ulëset për nxënës dhe shporta varëse për mbeturina nëpër oborre të shkollave. Mandej kërkoi nga Drejtoria për Inspektime që inspeksioni sanitar, i mjedisit dhe i higjienës të vizitojnë të gjitha shkollat në territorin e Vushtrrisë dhe me shkrim të na raportojnë për parregullsitë në të cilat hasin gjatë kontrollimit për secilën shkollë. Pastaj kërkoi nga Drejtoria për Arsim, që nga Inspektorati i arsimit regjional që të bëjë hospitime në të gjitha shkollat dhe zyrtarët e DA-së t’i vizitojnë shkollat më shpesh.

**Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar informatës në fjalë, tha se e përkrah propozimin lidhur me angazhimin e nxënësve nëpër shkolla teknike, pasi që e ardhmja e zhvillimit të Kosovës do të varet shumë nga çështja e zhvillimit ekonomik dhe teknik, ku janë shkolla teknike dhe profesionale, mirëpo zhvillimi dhe angazhimi i nxënësve në shkollat teknike nuk mund të jetë më i mirë, përderisa mungojnë laboratorët e konkretizimit, prandaj komuna duhet ta ndryshojë gjendjen në këtë drejtim. Kurse lidhur me informatën për maturanët, 64 % kanë kaluar, kurse 35 % jo, dhe kjo është e arsyeshme, por brengosëse është që në bazë të disa informacioneve Ministria e Arsimit bën ndërhyrje edhe pas mbajtjes së testimit, rreth 20 nxënës kanë marrë ekstraktin e diplomës, pa i plotësuar konditat, duke shtuar se në mesin e këtyre nxënësve ka nxënës që i kanë 38 poena, pra distanca është për 10 poena, dhe nga ky veprim diskriminohen nxënësit tjerë. Në fund tha se për të gjithë këta nxënës i ka emrat dhe mbiemrat e tyre.

**Xhylsime Feka, anëtare e Kuvendit-** tha se është brengosëse që raportet dhe informatat gjithmonë vijnë pozitive, kurse në praktikë është një gjendje tjetër. Pastaj si vështirësi përmendi rritjen e numrit të nxënësve që kanë vështirësi në përvetësimin e shkrim-leximit, prandaj pyeti se a është hartuar ndonjë plan për përmirësimin e gjendjes së nxënësve në fjalë, pasi që për çdo vit po rritet numri i tyre. Mandej shqetësues është edhe mbajtja e kurseve private nga arsimtarët të cilët njëkohësisht iu japin mësim edhe në shkolla, dhe për kurset e tilla edhe i kushtëzojnë gjatë notimit. Në vazhdim pyeti pse në SHMU 1 nuk mbahet lënda nga mbrojtja e mjedisit dhe ambientit, pasi që kjo është një mekanizëm shumë i rëndësishëm në ngritjen e vetëdijes lidhur me mbrojtjen dhe kujdesin ndaj ambientit, dhe e njëjta është e rregulluar edhe me konventë ndërkombëtare, duke shtuar se për këtë lëndë ekziston edhe teksti. Kurse lidhur me kalueshmërinë e nxënësve, tha se nuk duhet krijuar vetëkënaqësi nëse shifrat na japin rritje të kalueshmërisë së nxënësve, pasi që ka raste kur nxënësit gjatë tërë vitit e kanë të mbushur rubrikën me nota të dobëta, ndërsa në fund të vitit ata kalojnë, prandaj pyeti a ka ndonjë mekanizëm që një dukuri e tillë të mos jetë e pranishme. Gjithashtu, është e nevojshme prania e psikologut nëpër shkolla, dhe duhet të planifikohet në buxhetin e Drejtorisë së Arsimit për vitin vijues. Në fund, duke u bazuar në Ligjin mbi arsimin e ultë dhe të mesëm të ultë dhe të lartë, propozoi që të bëhet inspektimi më i shpeshtë i punës dhe procesit mësimor, së paku një herë në gjysmëvjetor.

**Bahrije Pllana, anëtare e Kuvendit-** lidhur me aktivitetet tjera të DA-së në shkolla, tha se i mungojnë këto paragrafe: është mbajtur konkursi “Gjuhëtari i ri” në Institutin Albanologjik, dhe vendin e parë e ka zënë Komuna e Vushtrrisë, konkretisht shkolla filllore “Bahri Kuqi”, nxënësja Lenditë Pllana; janë mbajtur garat regjionale në matematikë, dhe vendin e parë e ka zënë sh.fillore “Bahri Kuqi” nga Vushtrria, nxënësja Lenditë Pllana; ka pasur konkurs në nivel republikan në ese, dhe vendin e dytë e ka zënë sh.fillore “Bahri Kuqi” nga Vushtrria, nxënësja Vjenditë Pllana, prandaj pyeti pse mungon emri i saj, dhe shtoi se mund të jetë rastësi pasi që nxënësja në fjalë është vajza e saj.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar informatës në fjalë, paraqiti këto vërejtje: mungon informata për institucionet parashkollore private në Komunën e Vushtrrisë, duke shtuar se funksionojnë disa paralele parashkollore, prandaj do të duhej të informohemi a veprojnë në mënyrë legale; do të duhej të informohemi se a është i mjaftueshëm kapaciteti i institucionit parashkollor “Foleja” në Vushtri apo ka nevoja shumë më shumë, dhe nëse ka, do të duhej Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me kryetarin e komunës të mendojnë në ngritjen e ndonjë çerdheje tjetër publike në Vushtri; mungon informata rreth funksionimit që 4 vite, të 5-6 shkollave të paemërtuara; mungon informata rreth telasheve që ka pas ndonjë shkollë me rastin e fillimit të vitit shkollor, duke shtuar se vitin e kaluar gjimnazi dhe shkolla e mesme e ultë për disa ditë me radhë nuk kanë mbajtur mësim për shkak të mungesës së ngrohjes. Kurse lidhur me kuadrot në shkolla, tha se ka raste kur lëndën e Kimisë e ligjëron profesori i Biologjisë, dhe në këtë mënyrë nxënësit ndëshkohen pa fajin e tyre. Gjithashtu kuadri në matematikë është shumë deficitar, prandaj autoritet komunale duhet të gjejnë forma për të stimuluar ata që dëshirojnë të studiojnë matematikën. Në fund, tha se në raportin e kryetarit për situatën ekonomiko-financiare e ka lexuar që janë ndarë mbi 6.000 € për mbjelljen e disa shemshirave të cilat janë mbjellë në rr. Gj.K.Skënderbeu, dhe një pjesë të drunjëve e ka mbjellur komuna, e një pjesë tjetër Shkolla e Policisë, prandaj pyeti çfarë logjike është të mbjellen shemshira në mesin e dy palë drunjëve?

**Habib Mustafa, anëtar i Kuvendit-** tha se informata në fjalë i plotëson të gjitha kushtet dhe është informatë shumë e mirë. Gjithashtu në informatë flitet për shkollën e muzikës, për nxënësit që kanë përfunduar shkollën e mesme të ultë. Gjithashtu është pozitive që në këtë vit numri i nxënësve në paralele në klasët e para ka një



rritje, pasi që vitin e kaluar ka pas një rënie. Në vazhdim kërkoi nga drejtori i arsimit që të bëjë vizita më të shpeshta nëpër shkolla, duke kërkuar që në informatën e radhës të tregohet se sa herë i ka vizituar shkollat e Komunës së Vushtrrisë.

**Islam Krasniqi, anëtar i Kuvendit-** në emër të disa përfaqësuesve të fshatrave të ndryshme kërkoi që shkollat të cilat nuk kanë fotokopjues, të pajisen të gjitha me fotokopjues.

**Qerim Selimi, drejtor i Drejtorisë për Arsim-** sa i përket vërejtjes se rezultatet janë të fryra, nuk u pajtua duke shtuar se gjendja e paraqitur është realitet, pasi që janë të bazuara nga raportet e shkollave. Pastaj lidhur me vërejtjen për mungesën e teksteve shkollore në shkollat e mesme profesionale, tha se është e vërtetë që mungojnë tekstet shkollore, por shtoi se mungon edhe angazhimi i mësimitdhënësve, pasi që secili mësimitdhënës mund ta përgatitë një material dhe Drejtoria për Arsim do t'ia mundëson fotokopjimin e tij në kopje të nevojshme. Kurse sa i përket sigurisë nëpër shkolla, tha se nuk ka asnjë të dhënë, duke njoftuar se komuna paguan edhe kompani të sigurimeve nëpër shkolla të mesme për të qenë nxënësit sa më të sigurt. Pastaj njoftoi se shkolla e muzikës është e hapur si paralele e ndarë e shkollës së Mitrovicës, dhe në bashkëpunim me drejtoreshën janë zgjidhur 50 nxënës, dhe përzgjedhja e kuadrove është bërë nga drejtoresha aktuale e shkollës së muzikës dhe ish-drejtoresha, por është një problem pasi që në shkollë të muzikës ka kërkesa që mësimitdhënësit e kualifikuar të muzikës nga shkolla fillore të kalojnë në shkollën e muzikës, dhe pastaj do të krijohet boshllëk për shkak të mungesës së kuadrove të muzikës në shkollat fillore, duke shtuar se nëse ka bazë ligjore këtyre mësimitdhënësve do t'iu ipet edhe një pagë sekondare, edhe pse një gjë e tillë është vështirë të realizohet. Në vazhdim njoftoi se është në fazën përfundimtare furnizimi me drunj dhe thëngjill nëpër shkolla. Kurse lidhur me mungesën e punëtorive nëpër shkolla profesionale, tha se shkolla profesionale "Bahri Haxha" është e furnizuar me laborator të teknologjisë ushqimore, me ç'rast janë krijuar kushte të mira për praktikë profesionale, gjithashtu ka serrë dhe mjete bujqësore, kurse për shkollën teknike jemi duke bërë përpjekje për ta liruar bufenë, dhe aty do të vendosen dy laboratorë të shkollës në fjalë, dhe në këtë mënyrë do të krijohen kushtet që të realizohet praktika. Sa i përket vërejtjeve lidhur me testin e maturës, tha se të gjithë ata nxënës që i kanë arritur 48 apo 49 pikë, dhe dy pyetje nga testi i maturës të cilat kanë mundur të mos jenë të formuluar mirë, ato janë konsideruar të sakta, dhe kjo ka ndikuar që pas publikimeve të rezultateve, të ketë edhe lëvizje të tilla, kurse për rastet që kanë pasë 38 pikë nuk është i informuar, prandaj paraqiti interesimin që të informohet për rastet e tilla, në mënyrë që këtë çështje ta paraqet në Ministrinë e Arsimit. Ndërsa, lidhur me kurset private, tha se në Drejtorinë për Arsim nuk ardhur asnjë ankesë nga prindërit dhe nxënësit. Gjithashtu njoftoi se lënda "Mbrojtja e ambientit (mjedisit)" mësohet në biologji, kimi, duke shtuar se Drejtoria e Arsimit ka marrë vendim që të lejohet mësimi zgjedhor nga lëndët e ndryshme, me qëllim që të mbulohen normat e mësimitdhënësve, mirëpo mësimi zgjedhor do të ketë vetëm për lëndët që i nënshtrohen testit të arritshmërisë. Ndërsa, lidhur me vërejtjen pse nuk është përfshirë në informatë nxënësja Vjenditë Pllana, tha se ka qenë një raport i mëparshëm në të cilin është përfshirë sh.fillore "Bahri Kuqi" për suksesin e arritur, mirëpo nuk është cekur emri i nxënësës në fjalë, duke shtuar se për testin "gjuhëtari i ri" vijnë përgjigjet e sakta, dhe iu shpërndahen nxënësve. Lidhur me institucionet private për parafillor, tha se Drejtoria për Arsim nuk ka shënime, por këto shënime duhet kërkuar nga sektori i inspeksionit, dhe shtoi se sistemi parashkollor është i instaluar vetëm në shkollën "Mustafë Venhari", por do të bëjmë përpjekje që mësimi parashkollor në qytet të mbahet në kuadër të shkollave dhe të financohet nga Drejtoria për Arsim. Pastaj tha se kuadri i mësimitdhënësve të matematikës mungon vetëm në shkollat e mesme, të cilët i kanë studimet baçelor ose shkolla të larta, por kanë përvojë të gjatë. Në vazhdim tha se nëpër disa shkolla mungojnë deponitë për vendosjen e lëndëve djegëse. Gjithashtu njoftoi se bën vizita jo të rregullta nëpër

shkolla, por i viziton të gjitha shkollat e Komunës së Vushtrrisë, gjithashtu shtoi se 95-98 % e shkollave janë furnizuar me fotokopjues. Sa i përket regjistrimit në klasën e X-të, tha se nuk ka asnjë klasë që ka më shumë se 41 nxënës, dhe në këtë vit shkollor nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm që nuk kanë mundur të regjistrohen në gjimnaz për shkak të numrit të kufizuar, janë regjistruar në shkollat profesionale, dhe numri i nxënësve të regjistruar në klasën e X-të është 455 në gjimnaz, në shkollën e mesme teknike 456, ndërsa në shkollën e mesme profesionale 391 nxënës, pra janë regjistruar 1302 nxënës në shkollat e mesme. Kurse lidhur me testin e maturës, tha se 1011 nxënës kanë hyrë në provim në qershor, ndërsa kanë kaluar 30 %, pastaj 70 %-shi iu ka nënshtruar provimit të gushtit dhe është paraqitur kalueshmëria e dy afateve. Gjithashtu njoftoi se në shkollën “Nazim Zhegrova” janë hapur katër konkurse për drejtor të shkollës, por askush nuk ka konkurruar që i plotëson kushtet. **Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit**- lidhur me rezultatin e maturës, tha se ka lajthitje, duke shtuar se paska pas edhe afat të tretë, dhe shtoi se ka elemente subjektive.

#### **4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për mbrojtjen e mjedisit (shqyrtimi i parë).**

**Idriz Ismajli- drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit**- tha se draft-rregullorja në fjalë është përgatitur në harmoni me Ligjin për mbrojtjen e mjedisit, dhe shtoi se në mungesë të kuadrit ka qenë e pamundur të procedohet më herët. Në vazhdim paraqiti sqarime shtesë lidhur me draft-rregulloren në fjalë.

**Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit**- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se është në dilemë a të quhet rregullore e mjedisit, ku është i inkorporuar edhe plani i veprimit për mbrojtje të mjedisit, dhe që sipas Ligjit për mbrojtje të mjedisit kuvendi komunal është i obliguar ta aprovojë planin e veprimit për mbrojtje të mjedisit, kurse neni 21 i draft-rregullores në fjalë ka emërtimin “Plani lokal i veprimit në mjedis dhe programet mjedisore”, prandaj nuk është në rregull nëse është menduar që bashkarisht me rregulloren për mbrojtje të mjedisit të përfundojë edhe më këtë plan lokal të veprimit në mjedis dhe programit mjedisor, pasi që plani i veprimit për mbrojtje të mjedisit duhet të aprovohet ndaras, sepse në vitin 2006 në nivel të Qeverisë së Kosovës është aprovuar “Plani i Kosovës për veprim në mjedis”, dhe propozoi që Komuna e Vushtrrisë gjatë diskutimit publik t’i shfrytëzojë edhe dy bashkëqytetarët tanë që kanë marrë pjesë në hartimin e planit në fjalë. Në fund tha se draft-rregullorja në fjalë si e tillë ka shumë të meta, pasi që nëse merret bashkarisht kjo draft-rregullore dhe plani për veprim për mbrojtje të mjedisit nuk përfshihen disa segmente shumë me rëndësi, duke shtuar se askund nuk përmendet mbrojtja e pyjeve, kurse në plan të veprimit në nivel të Kosovës për secilin janë të shkoqitur veç e veç, prandaj propozoi që gjatë diskutimit publik të ftohen grupe të interesit, qytetarët dhe të inkorporohen vërejtjet.

**Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit**- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se edhe rregullorja edhe plani i veprimit janë shumë të rëndësishme për komunën tonë për ambientin dhe mjedisin, kurse lidhur me kapitullin XII (Dispozitat ndëshkimore) paraqiti këto propozime: që me gjobën më të rëndë të dënohet çdo individ (piroman); problemi i duhanit të rregullohet më mirë; paragrafit 48.7 t’i shtohet një aline e re edhe për ata që i therrin bagëtinë në treg apo në vende publike, si dhe ata që hudhin ngordhësirat në vendet e pacaktuara. Pastaj tha se do të ishte mirë që të hyjë në rregullore edhe ndëshkimi për rrjedhat e ujit nëpër rrugica, të cilat mund të ndikojnë në përhapjen e sëmundjeve.

**Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit**- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se nuk mund të ketë sistem ekologjik të mbrojtur përderisa pyjet janë duke u shkatërruar. Pastaj lidhur me dëmtimin e pyjeve të Komunës së Vushtrrisë, tha se pylltarët dhe policia duhet të jenë në korelacion me atë se çka po ndodh me pyjet e komunës sonë, prandaj duhet të kemi konsideratë dhe t’i ruajmë pyjet dhe të kultivohet edhe mbjellja e drunjëve tjerë halorë që janë shumë të nevojshëm nëpër

fusha që janë të zbrazëta, e të cilat i menaxhon komuna jonë. Në vazhdim tha se përveç pyjeve, të rëndësishëm janë edhe ujërat, pra ruajtja e pasurisë ujore në komunën tonë, mirëpo ujërat nuk mund të ruhen, përderisa në disa lumenj dhe përrocka banorët e fshatrave i hedhin kanalizimet, duke shtuar se ka acide dhe detergjente që e kanë shkatërruar florën dhe faunën, por kjo mund të sanohet, pasi që urbanizimi i fshatrave nuk kërkon shpenzime të mëdha. Pastaj kërkoi që përveç lumenjve dhe përrockave, të mbrohet edhe lumi "Sitnica" i cili është i ndotur nga Obiliqi dhe nga ujërat e zeza që vijnë nga përrockat dhe lumenjtë që lidhen me lumin "Sitnica". Gjithashtu instalimi i gypave për bartjen e ujërave të zeza do ta zgjidhte problemin e ndotjes së ujit të lumit "Sitnica". Kurse ndërprerja urgjente e degradimit natyrës bëhet me ndërprerjen e eksplotimit të pyjeve pa kriter, prandaj në kuadër të dikasterit për bujqësi është mirë që të funksionojë zyra e pyjeve për mbrojtjen e pyjeve që së bashku me policinë të ndërmarrin masa disiplinore dhe gjyqësore për prerësit ilegal të pyjeve. Në fund kërkoi inventarizimin e hapësirave të djerra me drunjë halorë dhe me pisha, pasi që në këtë mënyrë do të rregullohet ambienti.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** e përkrahu draft-rregulloren në fjalë. Pastaj tha se është shumë me rëndësi ndërtimi i partneritetit të të gjithë akterëve që kanë ndikim me qëllim që kjo rregullore të zbatohet në praktikë, duke shtuar se ka raste nga e kaluara kur janë aprovuar dokumente nga kuvendi i komunës, por nuk janë zbatuar në praktikë. Sa i përket partneritetit, tha se edhe Drejtoria për Arsim luan rol të rëndësishëm. Pastaj lidhur me mbrojtjen e mjedisit, tha se duhet t'i kontribuojmë të gjithë duke u angazhuar, pasi që mbrojtja e mjedisit është mbrojtja e mjedisit tonë, mbrojtja e shëndetit të fëmijëve tonë, të bimëve dhe kafshëve tona.

**Veli Karaça, anëtar i Kuvendit-** tha se më herët është aprovuar një rregullore për shërbime publike dhe me aprovimin e kësaj rregulloreje disa nene duhet të harmonizohen dhe me një akt të veçantë duhet të shfuqizohen nenet e rregullores për shërbime publike, sidomos kur flitet për dispozitat ndëshkimore ku edhe shumat janë të ndryshme. Pastaj tha se gjatë diskutimit publik duhet të bëhet harmonizimi i këtyre dy rregulloreve, dhe nuk duhet të lihet hapësirë të gjobat, që te neni 45 thuhet "me gjobë prej 1000 € deri në 1500 € për shkelje ekologjike dënohet", prandaj si kuvend duhet të përcaktohem për një gjobë fikse.

**Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se është një materie e mirë, mirëpo është me rëndësi zbatimi i saj në praktikë, duke shtuar se nuk janë në pyetje vetëm sanksionet, por rëndësi ka sensibilizimi i përgjithshëm i të gjitha segmenteve të shoqërisë, kurse në rastin konkret propozoi që të hartohet një plan konkret i veprimit në terren rreth diskutimit publik, duke përfshirë edhe Komitetin Konsultativ për Mbrojtje të Mjedisit, segmentet e arsimit, të shëndetësisë.

**Naile Osmani, anëtare e Kuvendit-** Grupi parlamentar i PDK-së e përkrah draft-rregulloren në fjalë, pasi që e njëjta është e punuar në mënyrë të denjë nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit. Gjithashtu nuk u pajtua me konstatimin e disa anëtarëve të kuvendit se gjendja e ambientit nuk është e mirë në qytet, sepse nuk përket me realitetin, pasi që Drejtoria për Shërbime Publike ka punuar mirë në menaxhimin e mbeturinave.

**Bahrije Pllana, anëtare e Kuvendit-** propozoi që draft-rregullores t'i shtohet një paragraf përmes të cilit do të parashikohet shpërblimi i shkollës e cila ka ambientin më të mirë, fshati me ambientin më të mirë ose lagjja me ambientin më të mirë.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Ipet në diskutim publik Draft-rregullorja për Mbrojtjen e Mjedisit për Komunën e Vushtrrisë.***

***Diskutimi publik fillon nga data 28.10.2011 dhe zgjatë deri më 16.11.2011.***

## **5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës-tokës bujqësore dhe kullotat.**

**Nasuf Aliu, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim-** paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

**Zeqir Hasani, anëtar i Kuvendit-** tha se e përkrah propozim-vendimin në fjalë, në mënyrë që të mos mbesin djerrina në të ardhmen, por të shfrytëzohen nga bujqit tanë, por paraprakisht kërkoi nga drejtoria në fjalë që të formojë një komision për identifikimin e listës së pronave të cilat janë të uzurpuara, cilat janë prona pjellore që mund të shfrytëzohen nga bujqit dhe cilat janë prona jopjellore që nuk mund të shfrytëzohen nga bujqit, pra të bëhet një listë përfundimtare, në mënyrë që komuna të dijë se cilat janë pronat e saj.

**Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar vërejtjes që është paraqitur në fund të përshkrimit të parcelave, thuhet se identifikimi është bërë vetëm nga zyra, dhe nga kjo nënkuptohet se nevojitet shumë kohë për ta vërtetuar një realitet. Gjithashtu kur i lexojmë parcelat e përshkruara, pyeti pse anëtarët e kuvendit duhet ta votojnë, kur pjesa dërrmuese është duke u punuar, është e zënë, ka oborre të shkollave, ka xhamia, ka toka të komasacionit, ka shtëpi të banimit, prandaj këto çështje duhet definuar, jo nga zyrja, por nga terreni, duke shtuar se e përkrah dhënien e tokave, por të ipen në mënyrë reale dhe konkrete. Gjithashtu kërkoi që të informohen anëtarët e kuvendit se kush është duke e shfrytëzuar secilën tokë.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit-** tha se pronat në fjalë po jepen në bazë të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, dhe me këtë po mbrohet interesi publik, dhe dhënia në shfrytëzim e pronave në fjalë do të bëhet duke respektuar procedurat e prokurimit.

**Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se dilemat janë tek definimi i pronës, a ka konflikte me ata të cilët e kanë pronën, me ata të cilët e kanë marrë pronën në kohën e okupimit serb dhe ata të cilët do ta marrin në shfrytëzim. Pastaj kërkoi që të informohen anëtarët e kuvendit se kush ka shfrytëzuar pronën e Komunës së Vushtrrisë, dhe mbi bazën e cilave kritere e iu ka dhënë. Kurse parcelat që janë paraqitur, kërkojnë një qasje shumë serioze që të kategorizohet prona, pronari dhe të merren masat se ku ka mbetë në tri forma: ata që i kanë marrë, atyre që do t'i ipen dhe gjendja faktike se kush e ka uzurpuar, prandaj kërkoi një përgjigje konkrete për çështjen në fjalë.

**Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar njoftimit nga drejtoria në fjalë ku është thënë se është bërë identifikimi nga zyra, tha se askush nuk ua ka mohuar të drejtën për ta hulumtuar dokumentacionin ekzistues, dhe përmendi si shembull parcelën me mbi 7 hektar në fshatin Bukosh, shkolla e re, mirëpo ky kuvend aty ka ndarë 50 ari për shkollë, dhe është e ndërtuar edhe xhamia, por aty kurrë nuk kanë qenë 7 hektar, prandaj nëse është bërë identifikimi nga zyra, duke mos u bazuar në dokumentacionin ekzistues në organet komunale, lind dyshimi se sa janë reale edhe të dhënat tjera.

**Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit-** tha se gjatë shfletimit të materialit, në 50 raste shënon që është tokë e uzurpuar, prandaj është mirë që drejtoria përkatëse të identifikojë se sa hektar tokë të komunës janë të uzurpuar, duke identifikuar sipas rasteve, të dihen emrat e personave që kanë uzurpuar pronën komunale dhe të publikohen emrat e tyre. Gjithashtu një numër i madh i pronave kanë mbetur të pasqaruara, prandaj propozoi që të bëhet llogaritja totale e sipërfaqes së uzurpuar të tokës, duke kërkuar që të publikohet edhe lista me emrat e uzurpatorëve, kurse ndaj uzurpatorëve të hapet procedura gjyqësore.

**Nasuf Aliu, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim-** tha se në listën që ka paraqitur drejtoria janë 159 parcela, ku ka hektarë të tërë, ka parcela të atilla që ka shkolla ose xhamia, prandaj në këtë rast është ndërmarrë hapi, duke

shtuar se nuk mund të bëhet prerje, pa filluar me dhënien në shfrytëzim, dhe nëse merret ky vendim, nuk d.m.th që të gjitha parcelat të ipen gjatë kësaj sezone. Gjithashtu shtoi se ka filluar që të futet problematika në sistem, duke shtuar se nuk është vlerësuar gjithçka vetëm nga zyra, dhe gjendja fillestare është e bazuar në ortofotot e viteve të fundit dhe nga gjeodezia, kurse në ato parcela ku ka të vendosur xhami, shkollë ose ndonjë uzurpim, duke u bazuar në ligj do të evidentohen problemet e tilla. Ndërsa sa i përket shfrytëzuesve ilegal të parcelave, tha se pas marrjes së këtij vendimi nga kuvendi i komunës, shfrytëzuesit ilegalë do ta kuptojnë që këto parcela janë shpallur për dhënie në shfrytëzim, dhe me këtë rast edhe shfrytëzuesve ilegal do t'iu mundësohet hyrja në konkurrencë duke i respektuar procedurat e prokurimit.

**Nezir Klinaku, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë-** duke iu përgjigjur vërejtjes së I.Gashit, tha se në Drejtorinë për Kadastër ekziston edhe pjesa tekstuale dhe pjesa grafike e cila është e vitit 1959, kurse prej vitit 1991-1999 ka pasur ndryshime në kadastër, dhe ndarjet që janë bërë, nuk i kemi. Gjithashtu njoftoi se në Drejtorinë për Kadastër parcela nxirret edhe me numër të njësisë edhe me numër të certifikatës. Kurse lidhur me uzurpimet, pyeti se sa herë është shtruar çështja në kuvend që këto parcela bujqësore të ipen në shfrytëzim ose sa herë i ka punuar vet komuna. Mandej tha se në vitin e kaluar është shpallur një ofertë dhe kanë marrë pjesë disa qytetarë dhe në ato 8 parcela asnjëri nuk ka pas problem që i ka marrë në shfrytëzim kur ka shkuar për t'i lëvruar. Në fund njoftoi se komuna po jep tokë në shfrytëzim për bujqësi, e jo për ndërtime të objekteve.

**Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit-** tha se vërejtjen nuk e ka bërë pse janë paraqitur këto shënime, por vërejtja ishte sepse dokumentacioni ekziston në komunë, dhe ekziston vendimi i këtij kuvendi që nuk është kjo sipërfaqe, prandaj nuk është dashtë të paraqitet në këtë formë në kuvend. Pastaj tha se në të gjitha parcelat e kemi pushtetin juridik, mirëpo nuk e kemi pushtetin faktik, dhe nuk është në rregull që kuvendi të nxjerrë vendim dhe shpallë tender për dhënie në shfrytëzim aty ku nuk e kemi pushtetin faktik

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** tha se propozim-vendimi në fjalë me listën e pronave mund të jetë një nismë e mirë, mirëpo është e pamjaftueshme, prandaj nevojitet bashkëpunim i ngushtë i shumë institucioneve, pasi që bëhet fjalë për një çështje jashtëzakonisht të ndjeshme, siç është prona, prandaj në lidhje me pronat e komunës duhet të ngritet më shumë niveli i transparencës dhe bashkëpunimit ndër institucional. Në fund kërkoi që të identifikohen të gjitha pronat e uzurpuara të komunës.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** tha se një prej synimeve të tij ka qenë dhe është që të shfrytëzohet prona (pasuria) komunale prej komunës, dhe një prej pasurive komunale janë edhe tokat bujqësore, kullotat dhe malet. Pastaj njoftoi se për herë të parë vitin e kaluar ka filluar që të shfrytëzohet toka bujqësore duke përfutur komuna prej atij shfrytëzimi. Mandej tha se fillimisht duhet të bëhet identifikimi i pronave bujqësore, por edhe i kullotave, pasi që ka kërkesa edhe nga blegtorët për shfrytëzim të kullotave. Gjithashtu, përmes identifikimit të pronave, po qartësohet se cila është prona e Komunës së Vushtrrisë, duke u përfshirë identifikimi edhe i atyre që i kanë uzurpuar dhe që janë duke i shfrytëzuar. Kurse lidhur me dhënien e ndonjë parcele, tha se komisioni i prokurimit për secilën parcelë të interesuar duhet të dalë në terren për ta identifikuar parcelën përkatëse. Në fund tha se në secilën kontratë duhet të figurojë një nen, ku duhet të thuhet se në momentin që i nevojitet toka komunës, ndërpritet kontrata.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 17 vota "për", 10 "kundër", të tjerët "abstenim" vendosi me sa vijon:**

***Me këtë vendim lejohet dhënia me qira e të gjithë tokës bujqësore dhe kullotave në pronësi të Komunës së Vushtrrisë të konstatuara nga organet gjegjëse.***

***Patundshmëritë e evidentuara deri më tani por edhe ndonjë parcelë që mund të evidentohet në të ardhmen dhe që janë të shënuara me kulturë toka bujqësore dhe kullota të open me qira në afat kohor një deri në tri vite me mundësi vazhdimi.***

**6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.**

**Nasuf Aliu, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim-** tha se bizneset e materialit ndërtimor kanë kërkuar që t'iu mundësohet që edhe të dielave të punojnë, pastaj paraqiti sqarime shtesë lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

**Zeqir Hasani, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, dhe pasi që kjo kohë nuk është sezonë për ndërtimtari, propozoi në emër të Grupit parlamentar të AAK-së që ndryshimi i orarit të punës për ndërmarrjet që shesin material ndërtimor të fillojë të aprovohet prej 1 prillit deri më 31 tetor të vitit.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** tha se rregullorja në fjalë ka qenë në diskutim publik, dhe ka ardhur në kuvend që të aprovohet, dhe është thënë se nuk ka pasur propozime shtesë gjatë diskutimit publik, por tash po nënkuptohet se nuk paska qenë ashtu, pasi që bizneseve nuk po iu përgjigjet kjo rregullore, pra nga kjo po vërtetohet se diskutimi publik nuk ka qenë i mirëfilltë. Pastaj tha se është shumë me rëndësi bashkëpunimi i komunës (pushtetit) me bizneset, duke krijuar një partneritet me bizneset, pasi që bizneset janë bartëse të zhvillimit ekonomik. Gjithashtu, kërkoi që të shikohen edhe praktikrat e komunave tjera.

**Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit-** kërkoi që kuvendi të merrë vendim që propozim-vendimi në fjalë të shkojë në diskutim publik, pasi që ndryshimi dhe plotësimi i një rregulloreje që është në fuqi, është rregull që të shkojë në diskutim publik.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Ipet në diskutim publik Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.***

***Diskutimi publik fillon nga data 28.10.2011 dhe zgjatë deri më 16.11.2011.***

**7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e ditës festive “Dita e Patates”.**

**Nasuf Aliu, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim-** paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

**Hajrulla Muli, anëtar i Kuvendit-** propozoi që “Dita e Patates” të caktohet e premtja e parë e muajit tetor, dhe të jetë më masive duke i dërguar edhe nxënësit e drejtimit të bujqësisë, duke iu treguar nxënësve edhe në mënyrë praktike se si punohet dhe si kultivohet patatja në Komunën e Vushtrrisë.

**Ergin Sunguri, anëtar i Kuvendit-** propozoi që të bëhet një “festival i patates”, i cili do të zgjaste dy ditë, duke i ftuar në këtë festival edhe komunat tjera.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** tha se Komuna e Vushtrrisë është e njohur me prodhimin dhe me rendimente të larta të kultivimit të patates. Pastaj propozoi që të emërtohet “Festë tradicionale e ditës së patates” ose “Festë tradicionale e festivalit të patates”, gjithashtu propozoi që të festohet (organizohet) vetëm brenda një dite.

**Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit-** propozoi që kjo ditë të emërohet “Dita e patates së Kosovës”, dhe kërkoi që periudha kohore të përcaktohet përmes datës, e jo ditës.

**Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit-** propozoi që të ipet në diskutim publik propozim-vendimi në fjalë.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Ipet në diskutim publik Propozim-vendimi për caktimin e ditës festive “Dita e Patates” për Komunën e Vushtrrisë.***

***Diskutimi publik fillon nga data 28.10.2011 dhe zgjatë deri më 16.11.2011.***

**Në vazhdim të punimeve të Kuvendit, u diskutuan bashkërisht këto pika të rendit të ditës:**

**8.Shqyrtimi i propozim-vendimit për lejimin e mjeteve për transportimin e nxënësve të këtyre fshatrave: Kollë, Gumnishtë, Karaçë, Mihaliq dhe Liqej.**

**9.Shqyrtimi i propozim-vendimit për sigurimin e mjeteve për transportimin e nxënësve për këto shkolla: “Liria”, “Azem Bejta” dhe “Andon Zako Çajupi”.**

**Qerim Selimi, drejtor i Drejtorisë për Arsim-** paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me propozim-vendimet në fjalë.

**Vlora Qirezi, anëtare e Kuvendit-** tha se Grupi parlamentar i LDK-së mbështet propozim-vendimet në fjalë, mirëpo do të ishte më bindëse sikur në arsyetim do të figuronte edhe numri i nxënësve që do të udhëtojnë për në shkolla.

**Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit-** tha se i mbështet propozim-vendimet në fjalë, mirëpo është mirë që në disa drejtime, si në drejtim të Dubocit, Samadrexhës, kompanitë të cilat janë duke i mbajtur vijat, dhe nëse nuk janë të gatshme t'i shpeshtojnë oraret e qarkullimit, propozoi që të hapet një tender për vija shtesë, pasi që nuk është në rregull që nxënësit dhe udhëtarët tjerë të presin nga dy orë për t'u kthyer nëpër shtëpi, nga momenti i daljes nga mësimi. Gjithashtu propozoi që inspektori i komunikacionit t'i ftojë kompanitë që janë duke bërë bartjen, dhe nëse ata janë të gatshëm për të vazhduar me bartjen, le të vazhdojnë, por nëse nuk janë të gatshëm t'i shpeshtojnë linjat e qarkullimit, duhet të konkurrojnë të tjerët, dhe të mos kenë ata monopol mbi këto linja.

**Esat Beka, anëtar i Kuvendit-** tha se Grupi parlamentar i PDK-së i mbështet propozim-vendimet në fjalë.

**Në fund të diskutimit lidhur me këto dy pika të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Me këtë vendim lejohet sigurimi i mjeteve për pagesën e transportimit të nxënësve të këtyre shkollave:***

**a) Nxënësit e fshatit Kollë që udhëtojnë në SHFMU “28 Nëntori” në Vërnice me shumë 1.920 €.**

**b)Nxënësit e fshatit Kollë që udhëtojnë në SHFMU “Emin Duraku ” në Novolan me shumë 1.826 €.**

**c) Nxënësit e fshatit Gumnishtë dhe Karaçë që udhëtojnë në SHFMU “A.Z..Çajupi” në Vushtrri me shumë 1.896 €.**

**ç) Nxënësit e fshatit Mihaliq (lagjja Zenuni, Hajdari, Gela) që udhëtojnë në SHFMU “Abdyl Frashëri “ në Druar dhe Mihaliq me shumë 1.440 €.**

**d) Nxënësit e fshatit Liqej që udhëtojnë në SHFMU “Gj.K. Skenderbeu” në Pantinë me shumë 1.222 €.**

***Me këtë vendim lejohet sigurimi i mjeteve për transportimin e nxënësve të këtyre shkollave:***

**a. Nxënësit e paraleles së ndarë në Zhilivodë deri te fshati Bivolak, lagjja “Berisha”.**

**b. Nxënësit nga lagjet “Manova dhe Zymberi” në shkollën “Azem Bejta”.**

**c. Nxënësit nga lagjja “Sfarçaliu” në shkollën “A.Z. Çajupi”.**

***Transportimi i nxënësve sipas nenit 1, pika “a”, e këtij vendimi bëhet deri sa të përfundojë ndërtimin e objektit – shkollës në Zhilivodë.***

***Shuma totale është 1.400 € për një muaj, për transportimin e nxënësve sipas nenit 1 të këtij vendimi.***

## **10. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për përmirësimin e shërbimeve publike.**

**Veli Karaça, anëtar i Kuvendit-** tha se plani në fjalë ka mangësi si për nga forma, ashtu edhe për nga përmbajtja, duke filluar nga renditja e materialit, vendimi i kryetarit për formimin e këtij grupi, të gjitha këto harta, pasqyra e automjeteve të kompanisë rajonale të higjienës, dhe akronimet, të gjitha është dashtë të shkojnë në material shtesë. Pastaj tha se analiza e situatës vjen pas hulumtimit, dhe nxirren konkluzionet dhe rekomandimet. Ndërsa te profili i komunës, është dashtë me qenë hyrja, e jo analiza e situatës. Sa i përket hulumtimit, tha se është bërë në mënyrë joprofesionale, dhe si i tillë nuk mund të jetë i besueshëm, pasi që është përdorë vetëm një metodë, pra metoda e anketimit, kurse nuk janë përdorur fare edhe tri metodat tjera: intervista, vëzhgimi dhe dokumentimi. Gjithashtu, edhe pyetjet që janë bërë për hulumtim, nuk japin rezultate të cilat janë relevante për të nxjerrë një konstatim për gjendjen, pasi që nuk është ngritur asnjë hipotezë se çfarë është gjendja e hapësirave publike apo e ambientit. Kurse pas hulumtimit është dashtë të bëhet një analizë e rezultateve të hulumtimit, dhe pas çdo pyetje është dashtë të bëhet një konkluzion. Në fund tha se plani është i mangët dhe është vështirë që në bazë të këtij plani dikush të jepë ndonjë donacion, dhe shtoi se plani i veprimit do të ishte i mirë sikur të vinte pas një projekti.

**Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit-** e përkrahu planin e veprimit në fjalë, mirëpo disa shënime janë të reja, duke shtuar se edhe në të kaluarën kur është ndarë buxheti, 5.6 % kanë qenë për komunitete, kurse këtu po del se janë 8 %. Gjithashtu, tha se afatet e paraqitura, tashmë janë të tejkaluara, kurse te grupi ndihmës, tha se duhet angazhuar më shumë qytetarë, prandaj propozoi që të zgjerohet më shumë, duke përfshirë më tepër nga komuniteti.

**Në fund të diskutimit lidhur me këto dy pika të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Me këtë vendim aprovohet Plani i veprimit për përmirësimin e shërbimeve publike në Komunën e Vushtrisë.***

### **11. Të ndryshme:**

**a. Propozim-vendimi për transferimin e mjeteve nga mbetjet e projektit kapital të tenderuar të DSHMS-së;**

**b. Propozim-vendimi për transferimin e mjeteve buxhetore të komunës;**

**c. Propozim-vendimi për transferimin e mjeteve të lira.**

**Lidhur me këto tri nënpika të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Nga mjetet e lira të projektit kapital "Rëntgeni" 83141 programi 730 – Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, nënprogrami Shërbimet e Shëndetësisë Primare (74450), shuma fillestare e projektit 79,949.00 €. Prandaj shuma e mjeteve të mbetura dhe të lira të ridestinohet nga fondi burimor 10, në vlerë prej 21.199.00 € të kalojë në projektin kapital të ri (pajisje për Oksigjenim të QKMF-së) në drejtorinë, nënprogramin dhe vlerën e njëjtë (në shumën prej 21.199.00 €), gjithashtu në fondin dhjetë (10).***

***Me këtë vendim do të bëhet harmonizimi i mjeteve në kategorinë e pagave dhe mëditjeve nëpër të gjitha programet buxhetore.***

***Nga programet që kanë mjete të lira në kategorinë e pagave dhe mëditjeve të mbulohet minusi (mungesat) në programet tjera (në mungesë të mjeteve buxhetore).***

***Mjetet e mbetura të lira nga kjo kategori në shumë prej 52,774.00€, të transferohen në kategorinë mallra dhe shërbime në Drejtorinë Shërbime Publike, me qëllim të pagesës së obligimeve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të cilat kanë mbet të papaguara.***



**Me këtë vendim lejohet bartja e mjeteve të lira:**

- a) **Nga mjetet e lira të projektit kapital “Ndërtimi i shkollës fillore në Zhilivodë” me shumën 1,333.96 €.**
- b) **Nga mjetet e lira të projektit kapital “Ndërtimi i shkollës fillore në Bukosh” me shumën 19,696.12 €.**
- c) **Nga mjetet e lira të projektit kapital “Furnizimi i shkollës së muzikës me mjete muzikore” me shumën 2,232.00 €.**
- d) **Nga mjetet e lira të projektit kapital “Renovimi i shkollave” me shumën 137.92 €.**
- e) **Shuma e mjeteve të lira prej 23.400 € të barten në projektin e ri “Renovimi i shkollës fillore në Samadrexhë”.**

#### **ç. Pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.**

**Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të LDK-së kërkoi që për seancën e ardhshme të KK-së të sigurohet një regjistër me projektet kapitale për vitin 2012, të cilat janë aprovuar në seancën e muajit shtator 2011.

**Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit-** lidhur me përgjigjen që ka marrë për çështjen e “Shtëpisë së Kulturës” në fsh. Shtruhërë, por tha se përgjigjja nuk është adekuate, dhe shtoi se “Shtëpia e Kulturës” nuk është investim i komunës, por është e ndërtuar përmes një donacioni të huaj dhe destinimi ka qenë për Shtëpi të Kulturës, prandaj kërkoi që e njëjta t’i kthehet kulturës, dhe të pajiset me libra, të punësohet një punëtor i cili do të mirëmbante bibliotekën dhe Shtëpinë e Kulturës. Gjithashtu ngriti çështjen e pranimit të punëtorëve nga komunat tjera, kryesisht nga Skenderaj dhe Drenasi në fabrikën “Llakmos” në Vushtrri, duke shtuar që Vushtrria ka ekspertë të mjaftueshëm për udhëheqjen e fabrikës në fjalë. Pastaj tha se e njëjta po ndodh edhe me kompanitë ndërtimore, të cilat kompani të Komunës së Vushtrrisë paguajnë tatimin, kurse kompanitë tjera fitojnë tenderët dhe kryejnë punimet.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** tha se edhe në seancat e kaluara, Grupi parlamentar i LDK-së ka kërkuar që të paraqitet një raport (informatë) për të gjitha kontestet gjyqësore që i ka humbur komuna në gjykatë, dhe përsëri kërkoi që të përgatitet raporti i tillë, që do të përfshijë periudhën prej formimit të institucioneve (pas luftës), e deri sot, duke paraqitur edhe arsyet pse janë humbur kontestet. Pastaj duke iu referuar disa informatave, tha se në Prelluzhë ka pas bllokim të rrugës, prandaj është mirë të informohet kuvendi për problemin në fjalë. Gjithashtu, kërkoi informatë rreth punimeve për ndërtimin e urës në Prelluzhë.

**Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të AAK-së kërkoi informatë lidhur me gjendjen e obliguesve më të mëdhenj tatimor të firmave të ndryshme në Komunën e Vushtrrisë, si është gjendja e pagesës së tyre. Pastaj kërkoi informatë mbi trupat e përhershëm dhe të përkohshëm të punës së kuvendit, se a janë të konstituuar apo nuk janë, duke shtuar se disa nuk janë të konstituuar fare, prandaj është e nevojshme që të bëhet konstituimi i tyre. Kurse duke iu referuar dukurisë së zënies së tokave, kërkoi informatë kur janë zënë, kur janë ndërtuar, kur janë lejuar dhe a ka pëlqime nga Ministria e Bujqësisë. Mandej tha se gjendja e familjeve skamnore është në rritje, prandaj kërkoi informatë nga Qendra për Punë Sociale rreth numrit të familjeve që marrin asistencë sociale, a ka rritje të kërkesave. Po ashtu kërkoi informatë lidhur me përfituesit e materialit ndërtimor, kush ka marrë, sasinë që e kanë marrë, dhe kush nuk ka marrë material ndërtimor.

**Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit-** tha se “Shtëpia e Kulturës” në Shtruhërë është ndërtuar nga një donacion i CDF-së, dhe i tërë donacioni ka qenë për shoqërinë kulturo-artisitike “Bahri Kuqi”, prandaj destinimi është i caktuar dhe është mirë të ruhet ajo për çka është dhënë.

**Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit-** tha se i ka bërë disa pyetje për Drejtorinë e Arsimit, por i ka marrë përgjigjet vetëm për dy pyetje. Kurse për pyetjet që nuk ka marrë përgjigje janë: a mbanë Drejtoria e Arsimit drejtor pa kontratë pune, ose me

kontrata të skaduara, apo pa përgatitje adekuate, duke paraqitur me emra dhe mbiemra; gjithashtu ka kërkuar informatë që me emër dhe mbiemër të paraqiten se në cilat shkollat janë duke punuar në ciklin e ultë mësimdhënës pa kualifikim. Pastaj kërkoj që të hiqet praktika e mosdhënies të mbi 50 % të përgjigjeve nga ana e drejtorive komunale.

**Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të LDK-së kërkoj që të bëhet një rivlerësim i të gjitha ndërtesave të komunës, të cilat janë target i tatimit në pronë, sepse ka shumë sosh të cilat janë ndërtuar, në ndërkohë janë meremetuar katet e tjera ose anekset dhe ky është një burim i të hyrave vetjake për të cilat është shprehur shqetësim se nuk mund t'i mbledhim 1 milionë e 700 mijë euro, por vetëm 1 milion e 500 mijë euro, dhe shtoi se ky është një burim i mirë i rritjes së të hyrave vetjake.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** duke iu referuar shqetësimit të ngritur lidhur me punësimet nga komunat tjera në Fabrikën e Llamkosit, tha se Llamkosi është dhënë me procedurë të likuidimit, dhe sipas kontratës së lidhur me AKP-në e obligon që 437 punëtorë të cilët i ka propozuar sindikata, të gjithë t'i ftojë në punë, kurse për vendet tjera të punës është e drejtë e tij që ta përzgjedhë stafin tjetër, por duke mos i përfshirë në kuadrin e 437 punëtorëve. Kurse punimet për urën e Prelluzhës, tha se janë duke shkuar me një dinamikë të përshpejtuar dhe është afër finalizimi i projektit.

**Mbledhja përfundoi në orën 15:55.**

**Procesmbajtësi:**  
**Albanez Tahiraj**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Ferit Idrizi**

**Lektore:**  
**Vlora Krasniqi**